



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 dhjetor 2022
Nr. Ref.:RK 2100/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI124/22

Parashtrues

Liridon Uruqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit Pml. nr. 157/2020 të 3 shtatorit 2020
të Gjykatës Supreme të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Liridon Uruqi, i cili gjendet në vuajtje të dënimit në Burgun e Sigurisë së Lartë në Dyç, (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Fadil Sinanaj, avokat në Gjilan.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 157/2020] e 3 shtatorit 2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktvendimin [PAKR. nr. 29/2019] e 7 shkurtit 2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), në ndërlidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 139/2019] e 30 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 23 tetor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës si dhe nenin 10 (të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 6 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi më 11 gusht 2022.
7. Më 25 gusht 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR. KI124/22] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 15 gusht 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës si dhe i kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës, të saktësojë aktin e autoritetit publik të cilin e kontestonte dhe që të dorëzonte kopjet e vendimeve dhe ankesave që lidheshin me kërkesën e tij. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 1 shtator 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.

10. Më 30 shtator 2022, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
11. Më 10 tetor 2022, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar që dëshmon se kur parashtruesi e ka pranuar vendimin e kontestuar.
12. Më 13 dhjetor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 25 tetor 2018, Prokuroria Themelore në Gjiilan-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) ngriti Aktakuzën [PP. I. Nr. 173/2018], kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se kishte kryer veprat penale “*Vrasje rëndë*” nga nën-paragrafi 1.5, paragrafi 1 i nenit 179 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK), “*Vrasje e rëndë*” në tentativë të metë nga nën-paragrafi 1.5, paragrafi 1 i nenit 179 lidhur me nenin 28 të KPRK-së si dhe “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*” sipas paragrafit 1 të nenit 374 të KPRK-së.
14. Më 27 qershor 2019, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 209/18] e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprave penale si në vijim:
 - i) “*Vrasje e rëndë*” duke i shqiptuar dënimin me burgim prej njëzetë e tre (23) viteve.
 - ii) “*Kanosje*”, nga paragrafi 4 lidhur me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 185 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënimin me burgim prej dy (2) viteve; dhe
 - iii) “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*” duke i shqiptuar dënim me burgim prej një (1) viti.
15. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 209/18] e dënoi parashtruesin e kërkesës për veprat e lartcekura me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej njëzetë e pesë (25) viteve.
16. Më 12 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 209/18] të 27 qershorit 2019 të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit mbi sanksionin penal si dhe vendimin mbi shpenzimet e procedurës.
17. Më 12 shtator 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 398/2019] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Aktgjykimin [PKR. nr. 209/18] e 27 qershorit 2019 të Gjykatës Themelore, duke i kthyer çështjen penale gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje.
18. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata e Apelit vlerësoi se Aktgjykimi [PKR. nr. 209/18] i 27 qershorit 2019 i Gjykatës Themelore ishte i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal.

19. Më 30 dhjetor 2019, Gjykata Themelore, në rivendosje, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 139/19] e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprave penale si në vijim:
 - i) *“Vrasje”* nga neni 178 i KPRK-së, duke i shqiptuar dënimin me burgim prej tetëmbëdhjetë (18) viteve; dhe
 - ii) *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”* duke i shqiptuar dënim me burgim prej një (1) viti.
20. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 139/19] e dënoi parashtruesin e kërkesës për veprat e lartcekura me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) viteve e gjashtë (6) muajve.
21. Më 6 janar 2020, Prokuroria Themelore dorëzoi ankesën [PP. I. nr.173/2018] në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 139/19] të 30 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal.
22. Më 13 janar 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 139/19] të 30 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit mbi sanksionin penale si dhe vendimin mbi shpenzimet e procedurës.
23. Më 7 shkurt 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 29/2020] refuzoi ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe të Prokurorisë Themelore, duke vërtetuar Aktgjykimin [PKR. nr. 139/19] e 30 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore.
24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 139/19] të 30 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PAKR. nr. 29/2020] të 7 shkurtit 2020 të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.
25. Më 3 shtator 2020, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 157/2020] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 139/19] të 30 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PAKR. nr. 29/2020] të 7 shkurtit 2020 të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës si dhe nenin 10 të DUDNJ-së.
27. Parashtruesi i kërkesës thekson se atij i është ndaluar që t’iu bëjë pyetje dëshmitarëve në mënyrë të lirshme, pyetje të cilat sipas tij kanë qenë kruciale për të zbardhur vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.
28. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se aktgjykimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale dhe se arsyet vendimtare të paraqitura në aktgjykim janë kundërthënëse me njëra tjetrën, në kundërshtim me të drejtat

dhe liritë themelore të tij të garantuara përmes paragrafit 1 dhe 4 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 dhe pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ së.

29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të i) deklarojë kërkesën të pranueshme; ii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Pml. nr. 157/2020] e 3 shtatorit 2020 të Gjykatës Supreme, në lidhje me Aktvendimin [PAKR. nr. 29/2019] e 7 shkurtit 2020 të Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me Aktgjykimin [PKR. nr. 139/2019] e 30 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore; dhe iii) të kthejë çështjen në rigjykim.

Dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës

Ligji

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

Rregullorja e punës

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe [...].”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 të po të njëjtit nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë nga autoritetet publike, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
31. Gjykata më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, sipas paragrafit 1 të nenit 47 (Kërkesa individuale), çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. Sipas

paragrafit 2 të të njëjtit nen, individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

32. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [PPC. nr. 4/2015] e 10 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
33. Megjithatë, Gjykata po ashtu thekson se sipas nenit 49 (Afatet) të Ligjit, kërkesa duhet parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Kjo kërkesë është përcaktuar edhe përmes pikës (c) të paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcakton se kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
34. Në këtë kontekst, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 157/2020] e 3 shtatorit 2020 të Gjykatës Supreme. Fletëkthesa e dorëzuar në Gjykatë nga Gjykata Themelore vërteton që parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar më 23 tetor 2020.
35. Parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 6 gusht 2022, për më shumë se 1 vit e gjysmë pas pranimit të aktit të kontestuar. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës, dhe rrjedhimisht është e papranueshme për shqyrtim.
36. Në rastet kur parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që kopja e vendimit të plotfuqishëm të organeve gjyqësore vendase t'i dorëzohet në mënyrë automatike, qëllimit dhe synimit të nenit 49 të Ligjit më së miri do t'i shërbejë nëse afati katërmujor llogaritet nga data kur është dorëzuar kopja e atij vendimi (shih, rastin GJEDNJ-së, *Worm kundër Austrisë*, nr. 83/1996/702/894, Aktgjykim i 29 gushtit 1997, paragrafi 33).
37. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih, rastet e Gjykatës, KI48/21, parashtrues *Xhavit R. Sadrija*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 qershorit 2021, paragrafi 44; KI45/21, parashtrues *Samedin Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 majit 2021, paragrafi 35; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykim i 17 shtatorit 2014, paragrafi 258).
38. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, nëse përmes aktvendimit të kontestuar janë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (c) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 13 dhjetor 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani